ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 11(49)

Tirane, 15 Qershor 1939
15/6

Fort i ndershem ino lengj,

Mora letren t'uaj kur une e
kisha nisur letren qe besonj te kini
marre tani me Llambin. Atje do
te kini kenduar edhe per Kostaqin
qe me shkruante se vendosi te vinja
dhe e pres.

Numurat e rev. "Java" i kam ker-
kuar me kohe, po nga ndryshimet qe
ngjane s'kemi patur voli t'i marrim;
te "Minerves" nuk gjenden. Kalendari
t'em i benj gati dhe ua dergonj
me rastin e pare si edhe librin tjeter,
te cilin une e di se ju a kam der-
guar. Fletore Zyrtare me thane
qe s'esht e mundur te gjenden gjith
ato numura, ato kane vetem kole-
ksione te lidhur te vjeteve te fun-
dit; me dhane vetem nje Numur
(30) te ketij viti. Do te mundohem
perseri, listen e ruanj. Fundit ju
jap koleksionet qe kam une te
ketyre 2-3 vjeteve te fundit.

Nuk di ne se do te jete pjekur
Dhiakua me Violeten dhe ne se
i dhate nonje porosi. Se, ndonse ki-

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

sha vendosur të mos ju berdis për këtë tashi, e shoh që më mbeti pa paguar ky muaj i fundit (Qershor) se po vashdon akoma dhe s'di mirë as unë kur mbaron; duhen të paktën, 40 franga, të cilat mund t'ia dërgoni me çek të Bankës drejt në Shkollë, dhe duhen shpejt, kur se unë s'mund të kem të holla para fundit të muajit.

Në punë po vashdonj, po rroga nuk ësht shtuar akoma, se do bëhet bashkë me emërimet e përgjithshme, që priten të dalin. Z. Sheko mbeti në Ministrin' e Jashtme kur u nda Drejtoria e Shtypit dhe tashi që u mbyll Ministria e Jashtme ay mbetet, si të tjerët, në dispozision (διαθεσιμότητα).

Tjatër s'di ç' t'ju shkruanj. Punët përgjithësisht venë mirë, me rregull e organizim përparimtar. Kisi nuk digjohet fare.

Z. Kondi të fala, e mora letrën dhe i falem nderit për kujdesin dhe kujtimet e mira, Xoxa e gjeti shpërblimin si pas vepravet, i thoni, do t'a merrni vesh..

Me shtëpi jemi mirë të gjithë dhe ju puthim dorën.

Me nderime

Vasili

P. Sh. Nuk di, në se do të kthehet shpejt Dhiamua, që të mund të vinte bashkë me 'të edhe Violeta.